



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:240474
Datë: 18.09.2024
Numri i dokumentit: 06175263

C-IV-14-4505

Ankuesi:

I K, Vushtrri.

Kundër:

E paditura:

N.SH “Çyçavica”, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me dt.11 shtator 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1.APROVOHET ankesa si e bazuar dhe **NDRYSHOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.MIT042-0642 dt.15 maj 2014.

2.OBLIGOHET e paditura AKP, që ankuesit I K në emër të kompensimit për paga të papaguara, t'i paguaj shumën prej 1,687.00€. Kjo shumë e aprovuar do të përmbushet në pajtim me prioritetet sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.

3.REFUZOHET si e pa bazuar kërkesa, përtej shumës së aprovuar si në pikën 2 të dispozitivit të aktgjykimit.

4.Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.11 korrik 2014, ankuesi ish punëtor i NSH “Çyçavica” ka ushtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovë (më tej “Dhoma e Posaçme”) kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (më tutje AL) nr. MIT042-0642 i dt.16 maj 2014, me të cilin ka kërkuar kompensimin për paga të pa paguara për periudhën kohore 1992-1999 në shumë prej 8,363.00€, si dhe për periudhën 2000 deri më 2005 në shumë prej 1,687.00€. Ankuesi ka

deklaruar se ankesën e paraqet për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale dhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Ankesës i ka bashkangjitur këto prova: Aktvendimi E.nr.812/06 dt.09.10.2006 i Gjykatës Komunale në Vushtrri, Aktvendimi E.nr.358/06 dt.15.06.2006 i Gjykatës Komunale në Vushtrri, Aktvendimi C.nr.121/08 dt.30.08.2012 i Gjykatës Komunale në Vushtrri.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj lënde me dt.10 nëntor 2022 ka lëshuar një urdhër për ankuesin me anë të së cilit ka kërkuar që të paraqes prova shtesë në mbështetje të pretendimeve ankimore duke ia specifikuar secilën veç e veç. Ankuesi e ka pranuar urdhrin dhe me dt.21 nëntor 2022 i është drejtuar gjykatës me parashtrësë duke e bërë dorëzimin e këtyre provave: Kopjen e vendimit të kundërshtuar, Kopjen e vendimit MIT042-0641 dt.16.05.2014, Kopjen e librezës së punës, Letërkonfirmim nr.8600/2015-OUT dt.09.07.2015, Listë e punëtorëve, Lista e 20%, Vërtetim mbi dorëzimin e fletëparaqitjes – çregjistimin e sigurimit, Aktvendim mbi caktimin e punëtorit në vend tjetër të punës nr.270 dt.29.05.1991, Formular për aplikim për vërtetimin mbi përvojën e punës, Aktvendimi E.nr.358/06 dt.15.06.2006 i Gjykatës Komunale në Vushtrri, Procesverbal i seancës së shqyrtimit gjyqësor C.nr.121/08 dt.29.08.2012, Aktvendimi C.nr.121/08 dt.30.08.2012 i Gjykatës Komunale në Vushtrri.

Me dt.28 dhjetor 2022 e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje në ankesë, në të cilën pohoi se AKP e kundërshton në tërësi kërkesën e ankuesit, pasi që AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht e që objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e vendimit. Pra, vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë ligjore dhe nuk ka bazë për ta shfuqizuar andaj, ka kërkuar që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar.

Arsyetimi ligjor

Ankesa pjesërisht si e bazuar ankesa dhe ndryshohet vendimi i AL-së.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 par.2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa par.3 parasheh se *palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme*

për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse palët e tilla dështojnë që të paraqesin apo dorëzojnë provat e tilla, atëherë vlerësohet se palët nuk kanë përmbushur barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Në këtë rast gjykata gjen se, nuk është kontestues fakti se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, por nga shkresat e lëndës gjykata vie në përfundim se ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmojë se i takon kompensimin për paga të pa paguara për periudhën kohore 1992-1999 në shumë prej 8,363.00€ kurse, sa i takon kompensimit për paga të pa paguara për periudhën 2000 deri më 2005 në shumë prej 1,687.00€. Ankuesi në kuptim të argumentimit të kërkesës së tij ka dorëzuar këto prova: Kopjen e vendimit të kundërshtuar, Kopjen e vendimit MIT042-0641 dt.16.05.2014, Kopjen e librezës së punës, Letër konfirmim nr.8600/2015-OUT dt.09.07.2015, Listën e punëtorëve, Listën e 20%-shit, Vërtetim mbi dorëzimin e fletëparaqitjes – ç’regjistrimin e sigurimit, Aktvendim mbi caktimin e punëtorit në vend tjetër të punës nr.270 dt.29.05.1991, Formular për aplikim për vërtetimin mbi përvojën e punës, Aktvendimi E.nr.358/06 dt.15.06.2006 i Gjykatës Komunale në Vushtrri, Procesverbal i seancës së shqyrtimit gjyqësor C.nr.121/08 dt.29.08.2012, Aktvendimi C.nr.121/08 dt.30.08.2012 i Gjykatës Komunale në Vushtrri. Bazuar në këto prova, ankuesi e ka bërë të besueshme kërkesën e tij sa i përket periudhës kohore 2000 deri më 2005 në shumë prej 1,687.00€.

Nga kjo gjykata vjen në përfundim që parashtruesi i ankesës i ka përmbushur pjesërisht kriteret themelore të ankesës. Gjykata gjen se, në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të pa paguara për periudhën kohore 1992-1999 janë të pa bazuara, kjo për faktin se ankuesi nuk kishte marr asnjë veprim të ti kërkuar pagat për këtë periudhë duke mos iu drejtuar asnjë organi kompetent ose gjykatës në afatin prej 3 viteve, andaj kërkesa si e tillë në këtë drejtim ishte parashkruar. Kurse, për periudhën kohore nga viti 2000 deri më 2005, janë të mbështetura në provat e nevojshme materiale, prandaj si e tillë ankesa e tij është aprovuar pjesërisht si e bazuar.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par..4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do t’i bart shpenzimet e veta procedurale.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga data e pranimit. Ankesa duhet të parashtrohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r j a
Hajrie Shala